

## Raport për rezultatet e konsultimeve publike

### 1. Titulli i draft aktit – PROJEKTVENDIM “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SEKTORIALE TË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE 2023-2030”.

### 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Në datë 05.04.2024 është hedhur Dokumenti i Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Konsultimet në RENJKP janë mbyllur në datë 03.05.2024.

Në datë 08.04.2024, dokumenti është hedhur në sistemin E-akte.

Në vijim, në datë 3 Maj 2024 u organizua Komiteti Drejtues i Menaxhimit të Financave Publike, me qëllim lancimin e Strategjisë Sektoriale të MFP-së. Pjesë e këtij eventit ishin të gjithë aktorët e përfshirë në planifikimin e reformës së MFP-së (anëtarët e Komitetit Teknik dhe Drejtues), partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile. Pas komenteve të marra nëpërmjet sistemit E-akte, është vijuar me fazat e bashkërendimit dhe ribashkërendimit deri në marrjen e dakordësisë nga të gjitha institucionet.

### 3. Metoda e konsultimit

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Strategjia Sektoriale e MFP-së është konsultuar nëpërmjet:

- Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike;
- Komitetin Drejtues i Menaxhimit të Financave Publike;
- Arkivit Elektronik të Akteve të administruar nga Ministria e Financave;
- Shkresave zyrtare;
- Emailit zyrtar;

- Në datë 02.02.2024, dokumenti i Strategjisw Sektoriale e MFP 2023-2030 është ndarë me Partnerët për Zhvillim dhe Integrim (Pzhl nwpwrmjet dwrgimit me email si dhe me të gjitha njësitë e përfshira në Strategjinë e MFP-së.
- Në datë 05.04.2024 është hedhur dokumenti i Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Konsultimet në RENJKP janë mbyllur në datë 03.05.2024.
- Në datë 3 Maj 2024 u organizua Komiteti Drejtues i Menaxhimit të Financave Publike, me qëllim lancimin e Strategjisë Sektoriale të MFP-së. Pjesë e këtij eventi ishin të gjithë aktorët e përfshirë në planifikimin e reformës së MFP-së (anëtarët e Komitetit Teknik dhe Drejtues), partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile. Komentet e përcjella nga partnerët ndërkombëtar në vijim të takimit lancues, u ndanë me njësitë përgjegjëse të strategjisë së MFP-së dhe u reflektuan sipas rastit.
- Me anë të shkresës nr. 2285/26 Prot., datë 05.04.2024, dërguar edhe nëpërmjet sistemit e-akte, është përcjellë për mendim/konfirmim projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030”.
- Në vijim të komenteve të marra nëpërmjet sistemit e-akte nga disa institucione, Ministria e Financave ka përcjellë për bashkërendim shkresën nr. 2285/34 Prot, datë 14.05.2024, me lëndë “Mbi përcjelljen e shkresës për bashkërendim në kuadër të miratimit të Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030”.
- Ministria e Financave ka ripërcjellë nëpërmjet sistemit e-akte për bashkërendim shkresën nr. 2285/38 Prot, datë 07.06.2024, me lëndë “Dërgohet për ribashkërendim Projektvendimi për “Miratimin e Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030” te Ministria e Drejtësisë.

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.*

*Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.*

*Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.*

Nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nuk janë marrë komente.

Në vijim të shkresës dërguar për mendim nga Ministria e Financave me nr 2285 prot., datë 23.02.2024, u morën komente dhe sugjerime nga **8 institucione**, përkatësisht: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin; Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; Agjencia e Prokurimit Publik; Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës; Departamenti i Administratës Publike dhe Instituti i Statistikave.

Në vijim të shkresës dërguar për mendim nga MF-ja nëpërmjet sistemit e-akte me nr.2285/26 Prot., datë 05.04.2024, janë përcjellë komente nga 4 institucione, specifikisht nga: Departamenti

i Administratës Publike, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministria e Drejtësisë dhe Instituti i Statistikave.

Në 3 Maj 2024 u mbajt takimi i 17-të i Komitetit Drejtues të MFP-së i drejtuar nga Ministri i Financave. Pjesë e këtij event i ishin të gjithë aktorët e përfshirë në planifikimin e reformës së MFP-së (anëtarët e Komitetit Teknik dhe Drejtues), partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile. Në takim morën pjesë në diskutime Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Menaxheri i Bankës Botërore për Shqipërinë, Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, Menaxheri i Programit pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian, përfaqësues nga Agjencia Suedeze e Taksës, Zëvendëskryetari i misionit pranë Ambasadës Zvicerane, përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, përfaqësues nga Organizatat e Shoqërive Civile (Instituti i Shkencës/Open Data Albania).

#### **1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;*

*Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;*

*Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Çështja adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Komponenti 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale	Risqet fiskale: Komponenti 1.3 Menaxhimi i Riskut Fiskal: Masa 1.3.3 Forcimi i mbikëqyrjes fiskale të Ndërmarrjeve Shtetërore mund të mbulojë edhe forcimin e çështjeve të qeverisjes së NSH-ve. Ndryshe, mund të shtohet një masë tjetër për qeverisjen e NSH-ve. Kjo çështje u mbulua në raportin e FAD të dhjetorit 2023 dhe u diskutua me Ministrin në Takimet e Pranverës 2024.	Fondi Monetar Ndërkombëtar	Refuzuar	Çështjet e qeverisjes së NSH-ve janë përcaktuar në nenin nr.135 të ligjit përkatës nr. 9901, datë 14.04.2008 "Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ku saktësohet se çështjet e qeverisjes së NSH-ve janë nën detyrat/përgjegjësitë e tyre të Asamblesë së Përgjithshme, diçka që koordinohet nëpërmjet Njesisë së NSH-ve përkatëse të NSH-ve. Ministria e Ekonomisë (MEKI).  Prandaj, konsiderojmë se masa e rekomanduar është shumë përtej detyrës dhe përgjegjësisë së DFR-së në këtë rast, kështu që do të hiqet/ndryshohet.
Komponenti 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale	Gjithashtu, në këtë komponent mund të shtohet edhe një masë tjetër për forcimin e monitorimit dhe menaxhimit të risqeve fiskale lidhur me çështjet gjyqësore.	Fondi Monetar Ndërkombëtar	Refuzuar	Në deklaratën e riskut fiskal është përfshirë edhe monitorimi dhe raportimi i rasteve gjyqësore (rastet e arbitrazhit, rastet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Në aneksin nr.4 të udhëzimit nr.35, datë 29.12.2022, janë përcaktuar fushat përkatëse për raportimin e çështjeve gjyqësore. Vlen të përmendet se monitorimi dhe raportimi i çështjeve gjyqësore tashmë është përmirësuar dhe përfshin të dhëna për detyrimet faktike dhe ato të kushtëzuara.  Prandaj, konsiderojmë se masa e rekomanduar është e vonuar pasi tashmë është pjesë integrale e masës 1.3.1 "Pranimi i Deklaratës Vjetore të Riskut Fiskal dhe zgjerimi gradualisht i fushës së monitorimit dhe raportimit të riskut fiskal".
Komponenti 4.3 Prokurimi Publik	Kuatridhejsh ligjor për prokurimin publik është ndryshuar së fundmi përmes ligjit nr. 16/2024, i cili vendos kërkesën për krijimin e një Sistemi Elektronik të Prokurimit i cili bazohet në veçoritë e inteligjencës artificiale. Strategjia duhet ta përfshijë këtë aktivitet si pjesë e masës për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit, duke pasur parasysh se objektivi për krijimin e EPPS-së është gjithashtu pjesë e Strategjisë së Prokurimit Publik (nën konsultim).	Banka Botërore	Refuzuar	Aktiviteti i propozuar nga BB është përfshirë tashmë në Strategjinë e Prokurimit Publik.
Komponenti 4.3 Prokurimi Publik	Gjithashtu, brenda komponentit të prokurimit vërehet se prioritetet për periudhën 2023-2026 nuk janë paraqitur siç janë bërë për komponentët e tjerë.	Banka Botërore	Pranuar	Prioritetet që duhet t'i shtohen komponentit të PP: 1. Të garantojë efikasitet dhe qëndrueshmëri në procedurat e PP. 2. Përmirësimi i shqyrtimit të ankesave nëpërmjet përdorimit të sistemit elektronik të ankesave.
Komponenti 4.3 Prokurimi Publik	Për sa i përket treguesve, duket se këta po kapin pjesërisht 2 masa (Masa 4.3.1 Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit dhe Masa 4.3.3 Rritja e efikasitetit të sistemit të shqyrtimit të ankesave duke rritur shpejtësinë e vendimmarrjes). Ju mund të dëshironi të zgjeroni numrin e treguesve në mënyrë që të kapni plotësisht progresin në zbatimin e të gjitha masave të identifikuar.	Banka Botërore	Refuzuar	Tregues më të detajuar janë përcaktuar në Strategjinë e Prokurimit Publik.
Komponenti 1.3 Menaxhimi i Risqeve Fiskale  Komponenti 2.3 Menaxhimi i Investimeve Publike	2/ Angazhim më i fortë dhe më specifik mund të merret në lidhje me monitorimin dhe raportet analitike për PPP-të, NSH-të.  Edhe pse strategjia e MFP shpreh një përkushtim të qartë për përmirësimin e raportimit të rrezikut fiskal, ne mendojmë se mund të bëhen angazhime më të forta dhe më specifike për llojin e raporteve të monitorimit që do të prodhohen, dhe në veçanti për llojin, formatin, shpejtësinë dhe shtrirjen e raportimit të NSH/ PPP-ve që mund të presim në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Kjo në veçanti duke marrë shkas nga raportimi analitik i reduktuar për PPP-të në dy vitet e fundit, gjë që është një çështje shqetësuese. Për PPP-të mendojmë se është e këshillueshme rifillimi i menjëhershëm i publikimit të raportit të monitorimit me informacione analitike.	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri	Refuzuar	Në udhëzimin përkatës nr.35 datë 29.12.2022 të Pasqyrës së Riskut Fiskal janë përcaktuar: periudha e monitorimit dhe raportimit të risqeve fiskale (t-1), formatet, shpeshësia dhe shtrirja e të gjitha rreziqeve fiskale (përfshirë NSH/PPP). të cilat të gjitha janë diskutuar dhe kanë marrë 'miratimin' e Partnerëve. Kështu, çdo njësi raportuese raporton bazuar në anekset e tyre përkatëse (pa u kufizuar vetëm në fushat përkatëse të anekseve).  Në vend të kësaj, publikimi i raporteve të monitorimit të PPP-ve është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Drejtorisë së Koncesioneve në MF.
Komponenti 2.5	3/ Strategjia e MFP-së duhet të përfshijë një qëndrim mbi procedurat e rishikimit të buxhetit, dhe në	Delegacioni i Bashkimit	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, theksojmë se numri i Akteve Normative për rishikim

Monitorimi dhe Raportimi i Ekzekutimit te Buxhetit	<p>veçanti për përdorimin më të kufizuar të akteve normative.</p> <p>Strategjia e MFP-së nuk përmend apo nuk mban qëndrim për përdorimin e vazhdueshëm e të gjerë të akteve normative për ndryshimin e buxhetit. Ne mendojmë se strategjia duhet të përmbajë një pozicion të qartë se si të reduktohet dhe në mënyrë ideale të braktiset kjo praktikë në mungesë të situatave emergjente. Nevojitet një reflektim i qartë mbi praktikatat aktuale të rishikimit të buxhetit, i cili gjithashtu mund të çojë në një reflektim mbi dispozitat aktuale ligjore. Kjo mund të duhet të shoqërohet me një reflektim se si të sigurohen procedura specifike për rialokimin e buxhetit të lidhur me fatkeqësitë dhe si të zotërohen dhe vlerësohen më mirë rreziqet buxhetore që rrjedhin nga fatkeqësitë natyrore.</p>	Evropian në Shqipëri		<p>të buxhetit, ka shënuar rritje gjatë viteve 2019-2022 pasi ato janë përdorur nga Qeveria si një reagim i menjëhershëm për të zbutur ndikimin negativ të shkaktuar nga një sërë ngjarjesh të njëpasnjëshme, si p.sh. Tërmeti masiv i 2019, pandemia Covid19, kriza energjitike, kriza e çmimeve të inputeve pas luftës në Ukrainë, etj. Në çdo rast, të gjitha Aktet Normative të rishikimit të buxhetit të nxjerra ndër vite, janë përgatitur dhe propozuar në kushtet e "nevoja dhe urgjenca", duke përmbushur në mënyrë rigorozë këto kritere ligjore (informacionet e nevojshme në lidhje me plotësimin e këtyre kushteve ligjore parashihen dhe analizohen në raportin plotësues të çdo NA). Gjithashtu, Qeveria dhe Ministria e Financave janë të përkushtuara për reduktimin e përdorimit të Akteve Normative për ndryshimin e buxhetit dhe në këtë drejtim është e rëndësishme të theksohet se numri i Akteve Normative ka qenë në rënie progresive në 3 vitet e fundit. nga 6 NA gjatë VF2021 në vetëm 2 NA në VF2023.</p> <p>Lidhur me "procedurat specifike për rialokimin e buxhetit të lidhur me fatkeqësitë", çdo vit në ligjin e buxhetit vjetor planifikohet një fond për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si një "mekanizëm financiar" që mbështet politikën kombëtare për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. . Planifikimi i këtij fondi është në përputhje me aktet ligjore për mbrojtjen civile (ligji nr.45/2019), dhe procedurat specifike për rialokimin e këtij fondi për VF2024 janë përcaktuar në nenin nr.15 të ligjit nr.97/2023. "Për Buxhetin 2024". Për më tepër, kur përballemi me një ngjarje të paparashikueshme si fatkeqësi natyrore etj., sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave, Fondi Rezervë mund të përdoret gjithashtu për të financuar shpenzimet e paparashikuara që mund të lindin. Procedurat specifike për shfrytëzimin e fondit rezervë janë përcaktuar në nenin nr.5 dhe 45 të Ligjit Organik të Buxhetit.</p> <p>Lidhur me rreziqet nga fatkeqësitë natyrore, MF ka zgjeruar kuadrin e përgjithshëm të monitorimit të rreziqeve. Për këtë qëllim, në fund të vitit 2022 u miratua Udhëzimi nr.35, datë 29.12.2022 "Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të rrezikut fiskal për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë e tjera të sektorit publik", ku u futën kategoritë e tjera të rrezikut, përfshirë ato nga fatkeqësitë natyrore. FRS e parë, si dokument zyrtar, do të publikohet në fund të majit 2024 dhe për herë të parë do të përfshijë një kapitull në lidhje me rreziqet e fatkeqësive natyrore, i cili do të pajiset me informacione dhe të dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Në kuadër të ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve për monitorimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile por edhe Sektori i Riskut Buxhetor/MF ka marrë disa asistencë teknike nga partnerët ndërkombëtarë (BB, FMN) të cilat pritet të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2024.</p>
E përgjithshme	5/ Ne mendojmë se strategjia do të kishte përfituar nga adresimi në një mënyrë më horizontale të çështjeve të ngritjes dhe ruajtjes së kapaciteteve, dhe çështjeve të përgjithshme të zhvillimit strategjik të TI-së. Këto tani trajtohen në mënyrë të pabarabartë mbi komponentët e ndryshëm.	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, Ministria e Financave, në bashkëpunim me njësitë përkatëse, ka gjykuar se strategjia mund të përfitojë më shumë nëse për secilin komponent të prekur nga zhvillimet e IT dhe burimet njerëzore, merren masat përkatëse brenda komponentit për një qasje më të decentralizuar, duke siguruar një zbatim më efektiv.
Komponenti 3.3 Menaxhimi i Doganave	Kostoja: Në masën 3.3. ne besojmë se pjesa më e madhe e financimit (NCTS, Dritare Unike) do të vijë nga BB. Mbështetja e BE-së për ITMS dhe ngritjen e kapaciteteve. Në masën 3.1 do të ketë financim të BE-së për investimet në TI në kuadër të programit operacional për dixhitalizimin.	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri	Pranuar	Ne lidhur me komentin e Del te BE-se per komponentin 3.1, konfirmojme komentin.
E përgjithshme	Shumica e afateve janë për T4 2026. Ne do të duhet të shohim se çfarë masash të ndërmjetme mund të përdoren për të monitoruar progresin ndërkohë.	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, siç paraqitet në strategji, dokumenti i strategjisë përfshin objektivin deri në vitin 2030 për secilin nga komponentët, prioritetet dhe masat për periudhën 2023-2026. Në këtë kuadër, në fazën e

				planifikimit të planit të veprimit për periudhën 2026-2030, do të vlerësohen të gjitha masat me afat T4 2026, me qëllim përfshirjen e masave të reja për periudhën 2026-2030.
E përgjithshme	Po përdoren mjaft tregues të jashtëm (PEFA, SIGMA, etj.). Këtë vit do të ketë një PEFA & SIGMA, por nuk është e sigurt se si do të vazhdoni të monitoroni progresin në vitet në vijim (vetë-vlerësim?)	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri	Refuzuar	Lidhur me këtë koment, treguesi PEFA dhe SIGMA do të vetëvlerësohen siç është bërë në strategjinë e mëparshme.
E përgjithshme	Ka referenca për IPSIS, i cili aktualisht nuk është në përdorim si sistem. A do të bëhet kjo përmes aplikacionit aktual?	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri	Refuzuar	Referencat e përdorura IPSIS bazohen në Këshillin e Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të integruar të informacionit të planifikimit (SIPI/IPSIS)". Në të ardhmen do të merret në konsideratë çdo ndryshim në nivelin e ulët.
Përmbledhja ekzekutive	Ne rekomandojmë shtimin e Equity si një nga parimet e një buxheti të mirë, duke u përafuar me përfshirjen e tij në OBL (Ligji Organik i Buxhetit).	UN Women	Pranuar	
	5. Prezantoni rishikimet e shpenzimeve specifike për sektorin me një lente gjinore.	UN Women	Pranuar	
	Hartoni dhe zbatoni prokurime publike të gjelbra dhe prokurime të përgjegjshme gjinore.	UN Women	Refuzuar	Eshtë e paqarte se nga del një konkluzion i tillë. Sjellim në vëmendjen tuaj se legjislacioni i prokurimit publik parashikon qartësisht se procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë dhe mos dikriminimit duke trajtuar në të njëjtën mënyrë të gjithë operatorët ekonomikë, pavarësisht shtetësisë apo gjinisë së ortakeve apo aksionereve, administratorit apo drejtuesit të tij apo çdo personi tjetër që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje apo kontrolluese brenda tij.
	Në përputhje me SKZHIE 2022-2030, qëllimi i përgjithshëm është krijimi i një sistemi të menaxhimit të financave publike që garanton transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale dhe efikasitet dhe barazi.	UN Women	Pranuar	
	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 të pranuar plotësisht nga Komisioni Evropian e konsiderojnë në mënyrë eksplicite barazinë gjinore si një nga çështjet më urgjente për politikën e ardhshme me fokus qëndrueshmëri. Mundësia e reduktimit të hendeqeve gjinore është e njohur për nxitjen e rritjes ekonomike duke rritur punësimin dhe konkurrencën, dhe duke reduktuar varfërinë.	UN Women	Pranuar	
Shtylla 1: Programimi makroekonomik dhe monitorimi i rrezikut	Masa 1.1.4 Përfshirja e analizave makroekonomike të përgjegjshme gjinore në parashikimin e politikave fiskale dhe monitorimin e tyre.	UN Women	Refuzuar	Shprehemi se I gjejme jo relevante për të përfshirë si masa të detyrueshme për të ndermarre, të pakten jo për periudhën afatmesme, pasi: <ul style="list-style-type: none"> <li>Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal, projektin pritshmëri makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente</li> <li>Ndërsa, Kuadri i Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit (DSA) do të shërbejë si një mjet strategjik shtesë për programimin makroekonomik për të informuar më mirë vendimmarrësit për implikimet afatgjata të dinamikës së borxhit, duke kontribuar në praktikën e matshme të menaxhimit të borxhit dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të financave publike si dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.</li> </ul>
	Synimi për vitin 2030 është të ketë një sistem rregullash fiskale të pranuar përgjithësisht në kombinim me praktika të mira për programimin dhe parashikimin makroekonomik dhe zhvillimin e një sistemi të besueshëm dhe gjithëpërfshirës.	UN Women	Refuzuar	Shprehemi se I gjejme jo relevante për të përfshirë si masa të detyrueshme për të ndermarre, të pakten jo për periudhën afatmesme, pasi: <ul style="list-style-type: none"> <li>Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal, projektin pritshmëri makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente</li> </ul>

				<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndersa, Kuadri i Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit (DSA) do të shërbejë si një mjet strategjik shtesë për programimin makroekonomik për të informuar më mirë vendimmarrësit për implikimet afatgjata të dinamikës së borxhit, duke kontribuar në praktikën e matshme të menaxhimit të borxhit dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të financave publike si dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.</li> </ul>
	Duke garantuar ... të matur dhe të kujdesshme, si dhe gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme gjinore.	UN Women	Refuzuar	<p>Shprehemi se l gjejmë jo relevante për ti përfshirë si masa të detyrueshme për ti ndermarre, te pakten jo për ne periudhen afatmesme, pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal, projektton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente</li> <li>Ndersa, Kuadri i Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit (DSA) do të shërbejë si një mjet strategjik shtesë për programimin makroekonomik për të informuar më mirë vendimmarrësit për implikimet afatgjata të dinamikës së borxhit, duke kontribuar në praktikën e matshme të menaxhimit të borxhit dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të financave publike si dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.</li> </ul>
	<p>Masa 1.1.4 Përfshirja e analizave makroekonomike të përgjegjshme gjinore në parashikimin e politikave fiskale dhe monitorimin e tyre.</p> <p>Aktiviteti: Përdorimi i detyrueshëm i të dhënave dhe statistikave të ndara sipas gjinisë gjatë kryerjes së analizave makroekonomike&gt; Analiza duhet të përfshihet në “Kornizën Fiskale Makroekonomike” dhe në “Programin e Reformave Ekonomike”. fillimi T4 2024 fundi T4 2026 Partneret: UN Women</p>	UN Women	Refuzuar	<p>Shprehemi se l gjejmë jo relevante për ti përfshirë si masa të detyrueshme për ti ndermarre, te pakten jo për ne periudhen afatmesme, pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal, projektton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente</li> <li>Ndersa, Kuadri i Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit (DSA) do të shërbejë si një mjet strategjik shtesë për programimin makroekonomik për të informuar më mirë vendimmarrësit për implikimet afatgjata të dinamikës së borxhit, duke kontribuar në praktikën e matshme të menaxhimit të borxhit dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të financave publike si dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.</li> </ul>
	Aktiviteti: Sigurimi i përdorimit të të dhënave dhe statistikave të ndara sipas gjinisë në DSA. data e fillimit T4 2026 Partnerët UN Women	UN Women	Refuzuar	<p>Shprehemi se l gjejmë jo relevante për ti përfshirë si masa të detyrueshme për ti ndermarre, te pakten jo për ne periudhen afatmesme, pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal, projektton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente</li> <li>Ndersa, Kuadri i Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit (DSA) do të shërbejë si një mjet strategjik shtesë për programimin makroekonomik për të informuar më mirë vendimmarrësit për implikimet afatgjata të dinamikës së borxhit, duke kontribuar në praktikën e matshme të menaxhimit të borxhit dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të financave publike si dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.</li> </ul>
	Këtu, ne sugjerojmë përfshirjen e metodologjisë së Shënuesit të Barazisë Gjinore (GEM) në vlerësimin e projekteve të donatorëve. Nuk jemi të sigurt nëse është përfshirë tashmë ose nëse keni një metodologji ekzistuese për këtë qëllim. Megjithatë, ia vlen të diskutohet dhe UN Women është e gatshme të ofrojë mbështetje në këtë drejtim.	UN Women	Refuzuar	<p>SASPAC nuk ka asnjë koment apo sugjerim shtesë për shtyllat që janë nën përgjegjësinë e tyre.</p> <p>Komentet e bëra nga UN Women për Menaxhimin e Financave Publike, janë</p>

				përtej kompetencave tona institucionale.
	Ne rekomandojmë shtimin e mbështetjes teknike specifike për të siguruar integrimin e perspektivave gjinore në procese.	UN Women	Refuzuar	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike ka bërë pjesë të procedurave të PIM treguesit mbi Gender. Gjithashtu, ky tregues është përfshirë si një nga parimet baze për planifikimin e projekteve të investimeve. Cdo përfshirje e metejshme në strategjinë e PFM të treguesve të tjerë mbi Gender do vështirësonte zbatimin e procedurave aktuale. Ne kushtet aktuale do të vlerësojmë vendosjen e tyre në një fazë të mëvonshme.
	Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e përfshirjes ex-post GIA si një kërkesë e detyrueshme në metodologjinë për kryerjen e rishikimeve të shpenzimeve.	UN Women	Pranuar	
	Është shumë e rëndësishme të futet GIA ex-ante në studimet e fizibilitetit. Është futur në Vendimin e Këshillit të Ministrave për MIP, por është thelbësore të monitorohet zbatimi i kësaj kërkesë.	UN Women	Refuzuar	SASPAC nuk ka asnjë koment apo sugjerim shtesë për shtyllat që janë nën përgjegjësinë e tyre. Komentet e bëra nga UN Women për Menaxhimin e Financave Publike, janë përtej kompetencave tona institucionale.
	Ne sugjerojmë të shtohet një paragraf për ndryshimet e nevojshme në sistemin e TI-së dhe që duhet bërë për të lejuar etiketimin gjinor të projekteve si psh në AFMIS që konsiderohet një praktikë më e mirë shqiptare në nivel global.	UN Women	Refuzuar	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike ka bërë pjesë të procedurave të PIM treguesit mbi Gender. Gjithashtu, ky tregues është përfshirë si një nga parimet baze për planifikimin e projekteve të investimeve. Cdo përfshirje e metejshme në strategjinë e PFM të treguesve të tjerë mbi Gender do vështirësonte zbatimin e procedurave aktuale. Ne kushtet aktuale do të vlerësojmë vendosjen e tyre në një fazë të mëvonshme.
	Integrimi i një metodologjie të etiketimit gjinor në Modulin MIP Data e fillimit T4 2024 Data e përfundimit T1 2025. Partnerët: UN Women.	UN Women	Refuzuar	Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike ka bërë pjesë të procedurave të PIM treguesit mbi Gender. Gjithashtu, ky tregues është përfshirë si një nga parimet baze për planifikimin e projekteve të investimeve. Cdo përfshirje e metejshme në strategjinë e PFM të treguesve të tjerë mbi Gender do vështirësonte zbatimin e procedurave aktuale. Ne kushtet aktuale do të vlerësojmë vendosjen e tyre në një fazë të mëvonshme.
